

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “Insight Global” shpk,

Në Tiranë, sot më datë 23.09.2021, unë poshtëshënuari: MD Akhtaruzzaman Siddiki, i datëlindjes 31.12.1984, lindur ne Joypurhat Bangladesh, identifikuar me dokument identifikimi: pasaporte me numër personal ,BT0619815, me cilësinë e “ortakut themelues” deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar, “**Insight Global” shpk.**

Neni 1 Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin “**Insight Global” shpk**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

Neni 2 Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3 Selia

Shoqëria “**Insight Global” shpk** e ka seline në adresë: Rruga Qemal Stafa, Ndërtesa Numër 23, Hyrja 2, Ap 6, Njesia Bashkiake Nr 8, Tiranë” dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Objekti i ushtrimit të veprimtarisë për shoqërinë “**Insight Global” shpk** është: Zyre punesimi, ndërmjetesim mes punëmarresve dhe punëdhënësve në republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj.

Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

MD. Akhtaruzzaman Siddiki
ASiddiki

Neni 6 **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100,000 lekë, i ndarë në 1(nje) kuote e cilat zotërohet si më poshtë:

MD Akhtaruzzaman Siddiki, i datëlindjes 31.12.1984, lindur ne Joypurhat Bangladesh,identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte me numër personal ,BT0619815Z, zotëron 1(një) kuote që përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta. Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7 **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8 **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

Md. Akhtaruzzaman Siddiqi
A. Siddiqi

- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit; që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 Administrimi

Administrator i shoqërisë “**Insight Global**” shpk është:

MD Akhtaruzzaman Siddiki, i datëlindjes 31.12.1984, lindur ne Joypurhat Bangladesh, identifikuar me dokument identifikimi: pasaporte me numër personal ,BT0619815.

Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar. Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit te shoqërisë qe eshte data 23.09.2021.

Neni 10 Baza Ligjore


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11 Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike. Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare “**Insight Global**” shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKU THEMELUES

MD Akhtaruzzaman Siddiki



Tiranë, më datë 23.09.2021